



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Skupstina Opstine
Municipal Istog

Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.418/23

Datë:19.06.2023

Duke u bazuar në Ligjin Nr.02/L-52 Mbi Edukimin Parashkollor ,Udhëzimit Administrativ Nr.03/2022 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë, Drejtori Komunal i Arsimit në Istog ,shpall këtë:

K O N K U R S PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE PUBLIKE NË KOMUNËN E ISTOGUT PËR VITIN 2023/24

Drejtoria e Arsimit shpall konkurs për këto vende të lira në institucionet parashkollore publike në Komunën e Istogut

Vendet e lira në Institucionet parashkollore 2023-2024

Grup-mosha	IP. Gzimi Ynë Istog	IP.Pëllumbat e Ardhmërisë Rakosh	IP. Lulet e Jetës Vrellë	IP. Ardhmëria Jonë Gurrakoc	IP. Shpresa Jonë Banjë	Gjithsej
09 -> 2 vjet.	6		2	3	4	15
2-> 3 vjet.						
3-> 4 vjet.	5	4				9
4-> 5 vjet.						
5->6 vjet			3		3	6
Gjithsej	11	4	5	3	7	30

I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:

- Formulari i aplikimit (merret institucion përkatës parashkollor);
- Dokumenti personal i prindit (letërnjoftim ose pasaportë);
- Ekstraktin e lindjes së fëmijës;
- Certifikata e vendbanimit;
- Faturat e shërbimeve komunale, jo më të vjetra se gjashtë muaj;
- Për qiramarrësit – Kontratë e noterizuar mbi qiranë,
- Dëshmia nga mjeku për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të fëmijës;
- Dëshmia për vaksinimin e fëmijës (fletorja e shëndetit të fëmijës);
- Vërtetimi për marrëdhënien e punës për të dy prindërit (nëse prindërit janë në marrëdhënien e punës;
- Pasqyra e Trustit për gjashtë (6) mujorin e fundit;
- Dokumentet tjera të noterizuara për të dëshmuar kategorinë përkatëse janë të përcaktuara me vendimin 05.Nr.417/23 dt.16.06.2023

II. Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të fëmijëve në institucionet parashkollore

Regjistrimi i fëmijëve në IP do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parashkollor (Ligjit Nr. 02L-52 mbi Edukimin Parashkollor), në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 03/2022 për pranimin e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë dhe në Vendimin e kriterëve të pranimit të fëmijëve në institucionet parashkollore publike të Drejtorisë Komunale të Arsimit.

III. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur nga data **19.06.2023** e deri më datën **03.07.2023**;
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në institucionin parashkollor përkatës **çdo ditë pune prej orës 09:00 deri në ora 15:00**;
- Palët e pakënaqura me rezultatet e regjistrimit mund të ushtrojnë ankesë në Institutin parashkollor përkatës në afat prej (3) ditëve pas datës së publikimit të rezultateve.
- Palët e pakënaqura me rezultatet e regjistrimit mund të ushtrojnë ankesë në DKA, si shkallë e dytë, në afat prej tetë (8) ditëve; DKA nuk shqyrton asnjë ankesë, nëse e njëjta nuk është shqyrtuar me shkrim nga IP përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha dokumentacionet e pakompletuara dhe jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.



Drejtori i DKA-së
Naim Behlulaj

Behlulaj